



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË
VENDIM

Nr 85 Datë 18.09.08

PËR

Miratimin e vënies së emrit të personalitetit të mjekësisë shqiptare
Dr.Selaudin Qemal Mborja poliklinikës së qytetit

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatorët "Për miratimin e vënies së emrit të personalitetit të mjekësisë shqiptare Dr.Selaudin Qemal Mborja" poliklinikës së qytetit, në zbatim të ligjit nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "l" mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI:

1. Miratimin e emërimit të poliklinikës së qytetit "Selaudin Mborja"
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Politikave të Zhvillimit, Planifikimit Strategjik dhe Koordinimit me Donatorët.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari
Raimonda Nase
Raimonda NASE